

L I G J
Nr.8565, datë 22.12.1999

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË KONCENSIONIT TË FORMËS "BOT" NË
INDUSTRIËN E BAKRIT NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË PUBLIKE DHE
PRIVATIZIMIT DHE SHOQËRISË TË SË DREJTËS SË SHTETIT UTAH TË SHTETEVE
TË BASHKUARA TË AMERIKËS "THE METAL RESEARCH GROUP CORP", SI DHE
DHËNIES SË DISA STIMUJVE DHE GARANCIVE PËR KONCESIONARIN E KËSAJ
MARRËVESHJEJE**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Miratohet "Marrëveshja e Koncensionit të Formës "BOT" në Industrinë e Bakrit ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Shoqërisë të së Drejtës së Shtetit Utah të Shteteve të Bashkuara të Amerikës "The metal research group corp". Lista e objekteve të industrisë së bakrit, që jepen me koncension me këtë marrëveshje i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Në marrëveshjen e Koncensionit të formës "BOT" në industrinë e bakrit ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Shoqërisë të së Drejtës së Shtetit Utah të Shteteve të Bashkuara të Amerikës "The metal research group corp", kjo e fundit në cilësinë e palës koncensionare, nëpërmjet shoqërisë koncensionare, të themeluar prej saj, për një afat 5-vjeçar sipas marrëveshjes së koncensionit përjashtohet nga detyrimet e pagesës së taksave doganore dhe TVSH-së, për makineritë, linjat e pajisjet që do të përdoren për investime dhe për përmirësimin e gjendjes sociale të zonës së koncensionit.

Neni 3

Palët kontraktuese bien dakord midis tyre për zbatimin e detyrimit të parashikuar në pikën 5 të nenit 11 të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 "Për koncensionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë".

Neni 4

Me hyrjen në fuqi të kontratës së koncesionit, Këshilli i Ministrave të trajtojë detyrimet ndaj shtetit dhe të tretëve që kanë shoqëritë tregtare "Albbakër" Sha Tiranë, "Prodhim kablllo" Sha Shkodër, "Ndërtim miniera metalifere" Sha Tiranë.

Neni 5

Me hyrjen në fuqi të kontratës së koncesionit, punonjësit që do të shkurtohen si rezultat i zbatimit të marrëveshjes, të trajtohen me një vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave, për të siguruar mbrojtjen sociale të tyre.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.2510, datë 17.1.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

KONTRATË KONCESIONI

E lidhur midis:

MINISTRISË SË EKONOMISË PUBLIKE DHE PRIVATIZIMIT, e cila më poshtë do të quhet "Organ Shtetëror i Autorizuar (OSHA)", caktuar nga Këshilli i Ministrave, nga njera anë dhe Kompania: THE METALS RESEARCH GRUP CORP., e cila që këtu e më pas quhet Koncesionari,

një person juridik i ligjshëm, sipas legjislacionit në fuqi të Shtetit UTAH, të Sh.B.A, regjistruar në Salt Lake City, të Shtetit UTAH Nr C54717, me seli në
SAN DIEGO CAL.
9605 SCRANTON ROAD SVITE 200 USA 92121

dhe

BRANCH OFFICE: 1560 BROADWAY STREET
PORT COQUITLAM. BRITISH COLUMBIA
CANADA V3C 6E6

nga ana tjetër.

Duke pasur parasysh që:

Në kuadrin e zhvillimit të ekonomisë së vendit, Qeveria Shqiptare i ka dhënë një rol prioritar zhvillimit të Industrisë Minerare në përgjithësi.

Legjislacioni në fuqi i Republikës së Shqipërisë krijon mundësitë për marrjen në koncesion të industrisë minerare. Kjo kontratë bazohet në ligjin nr.7973 datë 26.7.1995 dhe ndryshimet që i janë bërë atij.

Koncesionari është i interesuar të investojë në industrinë e bakrit për kërkimin, zbulimin, shfrytëzimin, pasurimin, proceset metalurgjike e të rafinimit deri në produktet përfundimtare të telave e kablllove.

Palët ranë dakort të bashkëpunojnë deri në fund për realizimin e objektit të kësaj kontrate.

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë me Vendimin nr.349 datë 28.7.1999 ka miratuar hartimin dhe negocimin e kontratës, si dhe ka autorizuar Ministrinë e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit si Organin Shtetëror të Autorizuar për negocimin dhe nënshkrimin e kësaj kontrate koncesioni.

Neni 1

Përkufizime

Kudo që në këtë kontratë përdoren termat e mëposhtëme, do të kenë kuptimet përkatëse të shënuara:

Kontratë Koncesioni: Dokumenti në fjalë (dhe anekset e tij).

Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA): MINISTRIA E EKONOMISË PUBLIKE DHE PRIVATIZIMIT.

Koncesionari: KOMPANIA "THE METALS RESEARCH GRUP CORP".

Projekt: Investimi në industrinë e bakrit për kërkimin, zbulimin, shfrytëzimin, pasurimin, proceset metalurgjike e të rafinimit deri në produktet përfundimtare të telave e kablllove.

Kontratat BOT: Çdo marrëveshje e bërë ndërmjet një investitori dhe një organi shtetëror të autorizuar për zhvillimin dhe zbatimin e një projekti sipas formës së koncesionit BOT (Ndërtim-Rehabilitim-Shfrytëzim-Transferim).

Kontratat: Të gjitha kontratat që mund të lidhen në të ardhmen nga koncesionari.

Të gjithë nënkontraktorët për projektin e zbatimit, ndërtimit, kërkimit, zbulimit, shfrytëzimit

dhe rehabilitimi.

Industria e Bakrit: Industria nxjerrëse e përpunuese e bakrit dhe Uzina e Telave e Kablllove, të specifikuara sipas aneksit Nr.1, bashkëlidhur kësaj kontrate.

Neni 2

Objekti i Koncesionit

Kjo kontratë ka për objekt të legjitimojë Koncesionin në Industrinë e Bakrit në formën BOT (Ndërtim-Rehabilitim-Shfrytëzim-Transferim) që OSHA i përcaktuar nga Këshilli i Ministrave, ia beson Koncesionarit, mbi bazën e termave dhe kushteve që vijnë për financimin, projektimin, rehabilitimin, administrimin, kërkimin dhe shfrytëzimin e zonave, vendburimeve, minierave, fabrikave të pasurimit, metalurgjisë, uzinës së rafinimit dhe uzinës së telave e kablllove, të specifikuara sipas aneksit Nr 1, bashkëlidhur kësaj kontrate.

Neni 3

Kriteret specifike të punimeve

Koncesionari angazhohet të realizojë investimet e nevojshme për një periudhë pesë vjeçare, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të kontratës.

Programi i investimeve për punimet që do të kryhen arrijnë vlerën 75 milion USD, të ndarë si vijon:

- vendburimi Munell	7 000 000 USD
- vendburimi Lak Rroshi, Perlat, Karma etj.	8 000 000 USD
-Metalurgjia dhe uzina Rubik	30 000 000 USD
- Uzina e Telave dhe Kablllove Shkodër	30 000 000 USD

Specifikimi i investimeve sipas objekteve dhe i ndarë në vite jepet sipas aneksit Nr.2, bashkëlidhur kësaj kontrate.

Neni 4

Koha e fillimit të punimeve

Marrësi i koncesionit do të fillojë punimet në bazë të kontratës brenda 90 ditëve të llogaritura nga data e hyrjes në fuqi të kontratës.

Neni 5

Detyrimet e Koncesionarit

Koncesionari brenda 30 ditësh nga nënshkrimi i kontratës së koncesionit do të formojë shoqëri koncesionare dhe të bëjë rregjistrimet e nevojshme për të lejuar shoqërinë të zhvillojë veprimtari në Shqipëri. Kompania do të jetë një shoqëri tregtare dhe do t'i nënshtrohet të gjitha dispozitave ligjore që rregullojnë veprimtarinë e shoqërive tregtare.

Koncesionari merr përsipër realizimin e objektit të kontratës që i është besuar në koncesion, brenda afateve të treguara dhe të përcaktuara në nenin 3.

Më hollësisht Koncesionari merr përsipër:

- të ndërtojë, rehabilitojë industrinë nxjerrëse e përpunuese të bakrit me mjetet e veta financiare, që kapin vlefën 75 milionë USD;
- të mbledhë të gjitha të dhënat dhe informacionet e nevojshme për projektin që do të zbatohet;
- të përpunojë projektin e zbatimit në përputhje me sa parashikohet në nenin 3;
- të kryejë punimet në përputhje me projektin;
- Koncesionari të mos pengojë OSHA-në të ushtrojë të drejtën e kontrollit mbi të sipas ligjit;
- Të mbajë të informuar OSHA-n për çdo rrethanë që mund të ketë ndikim në ekzekutimin (kryerjen) e Projektit;
- Të ndjekë, çdo punim që është me nënsipërmarrës, afatet, cilësinë në përputhje me kërkesat e kësaj kontrate;

- Të administrojë objektin e koncesionit gjatë periudhës së ushtrimit të tij;
 - Të ndjekë dhe të zbatojë të gjitha dispozitat për sigurimet shoqërore;
- Marrëdhëniet e punës midis punëdhënësit dhe punëmarrësit rregullohen sipas legjislacionit shqiptar në fuqi;
- të zbatojë masat e nevojshme për të garantuar jetën e shëndetin e punonjësve;
 - të marrë masa për ruajtjen e ambientit, pronës publike dhe pronës private duke respektuar normat teknike dhe ligjet në fuqi;
 - do të përjashtohet nga çdo lloj përgjegjësie e OSHA-së për sa parashikohet në këtë nen, qoftë për dëmet, dëmtimet dhe të tjera që mund t'i ndodhin Koncesionarit dhe punonjësve të tij gjatë kryerjes së koncesionit;
 - Koncesionari nuk përgjigjet për të gjitha detyrimet që objektet e marra në koncesion kanë ndaj shtetit dhe të tretëve deri në hyrjen në fuqi të kësaj kontrate;

Neni 6

Detyrimet e Organit Shtetëror të Autorizuar

Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA) merr përsipër të kryejë dhe të garantojë detyrimet e mëposhtëme:

- OSHA i vë në dispozicion Koncesionarit të gjithë dokumentacionin teknik dhe ekonomik të nevojshëm;
- t'i dorëzojë me proces verbal Koncesionarit objektet e industrisë nxjerrëse e përpunuese të bakrit sipas aneksit Nr.1 bashkëlidhur kësaj kontrate;
- OSHA merr përsipër zgjidhjen e çdo problemi që lidhet me pretendimet e personave të ndryshëm për pronësinë mbi objektet e dhëna në koncesion;
- të mbajë të lira kalimet dhe hyrjet në objekt;
- të garantojë asistencën e nevojshme për të ndihmuar Koncesionarin që të organizojë ruajtjen e nevojshme të objektit në përputhje me legjislacionin shqiptar;
- të ndihmojë Koncesionarin për të nxjerrë të gjitha autorizimet e nevojshme, lejet e punimeve, lejet e ndërtimeve, ato të mbrojtjes së mjedisit sipas kërkesave të bëra nga Koncesionari, me kusht që kërkesat e bëra të jenë të përpiluara e të paraqitura në formën që kërkon ligji.
- të ndihmojë Koncesionarin për kryerjen e misionit të tij pranë çdo organi e autoriteti shtetëror Shqiptar;
- të mbështesë Koncesionarin për ta përjashtuar nga tarifat doganore e TVSH-në për një periudhë pesë vjeçare për makineritë, linjat e pajisjet që do të përdoren për investime, si dhe për importe të tjera që i shërbejnë përmirësimit të anës sociale të zonës së koncesionit (sipas nenit 14 të ligjit nr. 7973 datë 26.07.1995).

Neni 7

Vlerësimi i investimit

Mbi bazën e të dhënave të disponueshme deri tani, investimi për objektin e kësaj kontrate, është vlerësuar 75 milion USD.

Vlerësimi i mësipërm mund të pësojë ndryshime që mund të shkaktohen nga ajo që del pasi të zhvillohet projekti në detaje nga Koncesionari, ashtu edhe nga mundësia dhe nevojat për të bërë të efektshëm qëllimin e koncesionit.

Neni 8

Periudha e Koncesionit

Në përputhje me këtë kontratë koncesioni, OSHA i beson koncesionarit për të shfrytëzuar për 30 vjet objektet e përcaktuara në nenin 3.

Periudha prej 30 vjetësh do të fillojë nga data e hyrjes në fuqi të kontratës.

Neni 9
Detyrim për Koncesionarin

Koncesionari detyrohet që me përfundimin e periudhës së koncesionit t'i transferojë OSHA-së së rehabilituar objektet e marra në koncesion.

Neni 10
Grafiku i Punimeve

Palët angazhohen të respektojnë programin si vijon:

a. koncesionari merr përsipër të fillojë punimet brenda 90 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e kontratës.

b. OSHA ka të drejtë të prishë kontratën në mënyrë të njëanshme nëse koncesionari brenda 6 muajve nga afati i përcaktuar në gërmën "a" nuk paraqitet për të realizuar detyrimet kontraktuale.

c. Koncesionari merr përsipër të kompletojë projektin (nëse ka nevojë) brenda 60 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e kontratës.

Neni 11
Zgjidhja e Koncesionit

OSHA ka të drejtë të kërkojë prishjen e kontratës së koncesionit për rastet kur konstaton shkelje të vazhdueshme dhe të rënda të obligimeve të marrësit të koncesionit në këtë kontratë, të cilat kompromentojnë grafikun e investimit, cilësinë e punimeve dhe kushtet e tjera themelore të kontratës.

Kur nga ana e OSHA-së verifikohen rastet e përmendura në paragrafin e mësipërm, ai menjëherë do t'ia bëjë të njohura këto raste marrësit të koncesionit dhe do të presë për një periudhë 30 ditore përgjigjen e tij me argumentat përkatëse. Mbi bazën e përgjigjeve do të arsyetojë për të filluar ose jo procedurën për prishjen e kontratës.

Në qoftë se OSHA do të vonohet në plotësimin e detyrimeve të kontratës, marrësi i koncesionit të njoftojë dhe të presë për 30 ditë përgjigjen e tij me argumentet përkatëse. Mbi bazën e përgjigjes do të arsyetojë për të filluar ose jo procedurat për prishjen e kontratës.

Secila palë ka të drejtë që krahas kërkesës për prishjen e kontratës të kërkojë edhe shpërblimin e dëmit të shkaktuar.

Neni 12
Garancitë

Garancitë e Koncesionarit.

Koncesionari garanton të kryejë të gjitha investimet dhe punimet që përmban ky akt me qëllim që të realizojë objektin e koncesionit. Projekti do të hartohet sipas standarteve dhe normave të specifikuar në aneksin Nr 2, bashkëlidhur kësaj kontratë dhe plan biznesit përkatës.

Garancitë e OSHA-së.

OSHA garanton të gjitha detyrimet e marra përsipër në nenin 6 të kësaj kontrate dhe merr përsipër të ndihmojë me qëllim që projekti të realizohet nga pala koncesionare.

Neni 13
Kontratat

Me qëllim që të realizohet objekti i koncesionit, Koncesionari ka të drejtë të lidhë kontrata sipërmarrjeje.

Përgjegjës përpara OSHA-së për zbatimin e rregullt të kontratave të sipërmarrjes mbetet gjithmonë Koncesionari.

Me përjashtim të të drejtave dhe detyrave që i jepen OSHA-së në këtë kontratë, OSHA nuk do të marrë përsipër asnjë detyrim kundrejt sipërmarrësve, furnizuesve dhe të tretëve në përgjithësi që kanë marrëdhënie me Koncesionarin.

Neni 14
Sigurimet

Objektet ku kryhen investimet gjatë periudhës së koncensionit sigurohen në institucionet përkatëse të sigurimit nga Koncensionari.

Koncensionari do t'i japë OSHA-së, me kërkesën e këtij të fundit, dokumentacionin e nevojshëm për të gjitha llojet e sigurimeve.

Neni 15
Kontrolli

OSHA në bazë të nenit 13 të ligjit Nr 7973, datë 26.07.1995, ruan të gjitha të drejtat kontrolluese mbi Koncensionarin.

OSHA nëpërmjet të dërguarve të tij mund të ushtrojë kontroll me synim për verifikimin e ecurisë së punimeve në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit të projekteve të koncensionit.

Koncensionari duhet të japë të gjitha sqarimet përkatëse.

Neni 16
Normat në Fuqi

OSHA garanton se çfarëdo ligji që mund të dalë më vonë se ky akt, nuk mund të ndryshojë detyrimet e marra përsipër nga palët në këtë kontratë.

Neni 17
Transferimi i fitimit

Për çdo rast dhe arësye nuk mund t'i mohohet Koncesionarit garancia mbi transferimin e lirë të fitimeve.

OSHA mund të ndihmojë në procedurat e konvertimit të monedhës shqiptare në valutë.

Neni 18
Legjislacioni që do t'i referohet

Për çdo gjë të paqartë në këtë kontratë palët do të mbështeten në legjislacionin shqiptar në fuqi, në momentin e firmosjes së kësaj kontrate koncensionit.

Neni 19
Forca Madhore

Kryerja e detyrimeve të Palëve mund të ndryshohet nga ngjarje të paparashikueshme që konsiderohen si forcë madhore. Konsiderohen ngjarje të Forcës Madhore katastrofat e natyrës, përmytjet, termetet, ngjarjet politike të jashtëzakonshme, si lufta dhe ndërhyrjet e të treteve që kanë forcën e ligjit.

Gjatë zbatimit të Kontratës, në rast se verifikohen ndodhi të Forcës Madhore, vonesa të mundshme ose mosrespektime të detyrimeve të Palëve, nuk mund të jenë motiv për kërkesa reciproke për zhdëmtim.

Përsa i përket në veçanti Programit të Përgjithshëm të Investimit, ai do të modifikohet si pasojë e nevojave që rrjedhin nga shkaku i ngjarjes së Forcës Madhore.

Periudha e ndalesës dhe ajo e shtytjes së afateve të parashikuara për kryerjen e detyrimeve përkatëse do të konfirmohen me anën e proces verbaleve midis palëve për këtë kontratë.

Neni 20
Hyrja në fuqi e Kontratës së Koncesionit

Kjo kontratë Koncesioni do të hyjë në fuqi kur: të jetë firmosur nga palët; të jetë ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në përputhje me ligjin nr.7973, datë 26.7.1995 "Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publik edhe infrastrukturë" (ndryshuar me akte të tjera ligjore).

Neni 21

Anekset

Anekset nr.1 dhe nr.2 janë pjesë përbërëse të kësaj kontrate.

Neni 22

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet midis Palëve do të zgjidhen me mirëkuptim.

Në rast se kjo nuk arrihet, Palët do t'i drejtohen Arbitrazhit të Dhomës së Tregtisë në Paris.

Neni 23

Bashkëpunimi midis OSHA-së dhe Koncesionarit

OSHA dhe Koncesionari angazhohen reciprokisht të bashkëpunojnë dhe të bashkëveprojnë midis tyre me qëllim që të garantojnë eficiencën maksimale të Projektit në çdo pjesë të tij.

Neni 24

Dispozita të Përgjithshme

OSHA dhe Koncesionari do të bëjnë të ditur emrin e përgjegjësit të autorizuar në administrimin e kësaj Kontrate Koncesioni.

- Kontrata është hartuar në gjuhën Shqipe dhe Anglisht, të gjitha dokumentat dhe lidhjet e caktuara do të jenë në të dyja gjuhët, njësoj të vlefshme.

- Kjo Kontratë është hartuar dhe nënshkruar në 3 ekzemplarë origjinale nga të cilët 2 (dy) në dispozicion të OSHA-së dhe 1 (një) në dispozicion të Koncesionarit.

Me përjashtim të marrëveshjes së kundërt nga Palët, e gjithë korrespondenca do të dërgohet me shkrim në adresat:

PËR OSHA: MINISTRIA E EKONOMISË PUBLIKE DHE PRIVATIZIMIT SHESHI SKËNDERBEJ Nr.2 TIRANË SHQIPËRI

- Për Koncesionarin: KOMPANIA "THE METALS RESEARCH GRUP CORP"

SAN DIEGO CAL.

9605 SCRANTON ROAD SVITE 200 USA 92121

dhe

BRANCH OFFICE: 1560 BROADWAY STREET
PORT COQUITLAM.BRITISH COLUMBIA
CANADA V3C 6E6

Palët marrin përsipër të ruajnë konfidencialitetin e kësaj Kontrate dhe të anekseve të saj.

Tiranë më 30.7.1999

PËR OSHA
MINISTRIA E EKONOMISË PUBLIKE
DHE PRIVATIZIMIT

PËR KONCESIONARIN
"THE METALS RESEARCH
GRUP CORP"

ZV/MINISTRI

PRESIDENTI

Viktor DODA

Robert PAPALIA

ANEKSI 1
LISTA E OBJEKTEVE QË JEPEN NË KONCENSION

1.0 GOLAJ

- 1.1 Vendburimi Krume
- 1.2 Vendburimi Nikoliq 1
- 1.3 Fabrika e pasurimit Golaj

2.0 FUSHË-ARRËZ

- 2.1 Vendburimi Fushë-Arrëz
- 2.2 Vendburimi Lak-Rroshi
- 2.3 Vendburimi Qafë-Bari
- 2.4 Fabrika e pasurimit Fushë-Arrëz
- 2.5 Parku i transportit të Albbakrit Fushë-Arrëz

3.0 REPS

- 3.1 Vendburimi Gurth Spaç
- 3.2 Vendburimi Spaç
- 3.3 Vendburimi Perlat Veriore
- 3.4 Fabrika e pasurimit Reps
- 3.5 Fabrika e pasurimit Rrëshen

4.0 SHKODËR

- 4.1 Vendburimi Karme
- 4.2 Fabrika e pasurimit Mjedë

5.0 REHOVË

- 5.1 Vendburimi Rehovë
- 5.2 Fabrika e pasurimit Rehovë

6.0 PARKU I TRANSPORTIT TË ALBBAKRIT RRËSHEN

7.0 RUBIKU

- 7.1 Metalurgjia Rubik
- 7.2 Uzina e rrafinimit Rubik
- 7.3 Impianti i skorjes Shëngjin

8.0 VENDBURIMI GJUZUJ

9.0 UZINA E BAKRIT LAÇ

10.0 N.N.M.METALIFERE TIRANË

11.0 UZINA E TELAVE DHE KABLLOVE SHKODËR

12.0 ZYRA E SHA. ALBBAKËR TIRANË

Shënim:

- 1. Të gjitha minierat dhe objektet e mësipërme do të jepen së bashku me asetet e tyre.
- 2. Në koncension jepen edhe vendburimet Munellë dhe Perlati Jugor, të cilët nuk përfshihen në kapitalin e Sha Albbakër.

Ligj nr.8555, datë 22.12.1999 "Për ratifikimin e marrëveshjes së asistencës administrative për parandalimin, zbulimin dhe ndëshkimin e shkeljeve doganore, ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Italisë";

Ligj nr.8556, datë 22.12.1999 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Kombeve të Bashkuara "Për të luftuar shkrejtëritëzimin në ato vende që kanë kaluar thatësi serioze

dhe/ose shkretëtirëzim, veçanërisht në Afrikë";

Ligj nr.8557, datë 22.12.1999 "Për miratimin e aktit normativ me fuqinë e ligjit të Këshillit të Ministrave nr.2, datë 16.11.1999 "Për një ndryshim në ligjin nr.8474, datë 14.4.1999 "Për miratimin e nomenklaturës dhe të tarifës doganore"";

Ligj nr. 8558 datë 22.12.1999 " Për disa ndryshime në ligjin nr.8474 datë 14.4.1999 " Për miratimin e nomenklaturës dhe të tarifës doganore"";

Ligj nr.8559, datë 22.12.1999 "Për miratimin e aktit normativ me fuqinë e ligjit të Këshillit të Ministrave nr.3, datë 2.12.1999 "Për një ndryshim në ligjin nr.8516, datë 22.7.1999 "Për disa ndryshime në ligjin nr.8439, datë 29.12.1998 "Për Buxhetin e Shtetit për vitin 1999"";

Ligj nr.8564, datë 22.12.1999 "Për ratifikimin e marrëveshjeve "Për Programin e Harmonizimit dhe të Integritetit të Kontrollit të Trafikut Ajror Europian (EATCHIP)" dhe "Për zbatimin e masave të menaxhimit të drejtimit të trafikut ajror nga njësi e menaxhimit qendror të drejtimit të fluksit (CFMU)" ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Organizatës Europiane për sigurinë e navigimit ajror (Eurocontrol)";

Ligj nr.8565, datë 22.12.1999 "Për miratimin e Marrëveshjes së Koncesionit të formës "BOT" në industrinë e bakrit ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Shoqërisë të së Drejtës së Shtetit Utah të Shteteve të Bashkuara të Amerikës "The metal research group corp", si dhe dhënies së disa stimuljeve dhe garancive për koncesionarin e kësaj marrëveshjeje".